



09-2837

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-239395/20 dt. 30.12.2020, të aplikuesit Hilmi Bujupi nga fshati Arllat, Komuna e Glllogoc, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e dy (2) shtëpive individuale të banimit - shtëpisë familjare, në kuadër të parcelave ndërtimore “I-28-7” dhe “I-28-8”, të bllokut urban “I-28”, të tërësisë urbane “I”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 24.03.2021 merr këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore** aplikuesit Hilmi Bujupi nga fshati Arllat, Komuna e Glllogoc, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-239395/20 dt. 30.12.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e dy (2) shtëpive individuale të banimit/shtëpisë familjare me etazhitet P+1, në kuadër të parcelave ndërtimore “I-28-7” dhe “I-28-8”, të bllokut urban “I-28”, të tërësisë urbane “I”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, në Prishtinë, përkatësisht në parcelat kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 ZK Çagllavicë.

**II. Lokacioni** i parcelave kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-186850 dt. 02.10.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Sipërfaqet e destinimit rezidencial - banimi individual”.

Për kriteret urbane, parametrat dhe kushtet e ndërtimit sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, pronari është informuar përmes “Shkresës” Informim nga Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, me referencë 04-350/01-228730/20 dt. 15.12.2020. të datës 24.12.2020, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës, përmes sistemit online.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit - parcelave kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 ZK Çagllavicë, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - nr. 873-15, me S= 383 m<sup>2</sup>, me pronar Hilm Bujupi, “Arë e klasës së 4-të;
  - nr. 873-16, me S= 319 m<sup>2</sup>, me pronar Hilm Bujupi, “Arë e klasës së 4-të;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjës së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Parcela kadastrale në fjalë, janë të zbrazët, edhe nuk ka ndërtesa të ndërtuara në to;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i relativisht i rrafshhtë;
- Parcela kadastrale e lartcekur, ka qasja në rrugës lokale, gjendje faktike rrugë me kubëza prej betoni të lagjes rr.“Shemsi Isufi”, përkatësisht në rrugën e planifikuar të planit rregullues;

- Qasja në parcela kadastrale e lartcekura, është përmes rrugës “Shemsi Isufi”, gjegjësisht parcelës kadastrale nr. 873-14 ZK Çagllavicë, me pronar/posedues “P.SH. Rrugët”, me gjendje faktike dhe kadastrale “infrastrukturë-rrugë e pakategorizuar;
  - Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është banim individual;
- IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin shtëpisë individuale të banimit, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:
- Organizimi me qasje në kuadër të parcelave kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik si dhe në bazë të “Situacionit” të parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
  - Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është “Sipërfaqet e destinimit rezidencial për banimi individual”. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
  - Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas PRrU-së, është P+2, ndërsa numri i etazheve nëntokësore nuk kufizohet, kurse etazhiteti i propozuar dhe i miratuar është P+1.
  - Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelave kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 ZK Çagllavicë, planifikohet ndërtimi i dy (2) shtëpive individuale banimit-shtëpisë familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim;
    - **Shtëpi familjare – Shtëpia - nr. Parcelës, 873-15**
    - Sip = 265.68 m<sup>2</sup> / E gjitha mbi tokë, me etazhitet P+1.
    - **Shtëpi familjare – Shtëpia - nr. Parcelës, 873-16**
    - Sip = 224.73 m<sup>2</sup> / E gjitha mbi tokë, me etazhitet P+1.
  - Pjesa e parcelës kadastrale e trajtuar me sipërfaqe brenda vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, për realizimin e shtëpisë individuale të banimit, është:
    - Parcelës, 873-15 ZK Çagllavicë.....me S = 340 m<sup>2</sup>;
    - **Totale; S = 340 m<sup>2</sup>;**
    - Parcelës, 873-16 ZK Çagllavicë.....me S = 279 m<sup>2</sup>;
    - **Totale; S = 279 m<sup>2</sup>;**
  - Pjesa e parcelës kadastrale e trajtuar me sipërfaqe jashtë vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, për realizimin e shtëpisë individuale të banimit, është:
    - Parcelës, 873-15 ZK Çagllavicë.....me S = 43 m<sup>2</sup>;
    - **Totale; S = 43 m<sup>2</sup>;**
    - Parcelës, 873-16 ZK Çagllavicë.....me S = 40 m<sup>2</sup>;
    - **Totale; S = 40 m<sup>2</sup>;**
  - Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore – (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë – gabarit të përdheses, sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është max. 0.4 (40 %).
    - **Shtëpi familjare – Shtëpia**
    - S = 340 m<sup>2</sup> x 0.4 (40%) = 136 m<sup>2</sup> / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
    - S = 127.23 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit;
    - **Shtëpi familjare – Shtëpia**
    - S = 279 m<sup>2</sup> x 0.4 (40%) = 111.60 m<sup>2</sup> / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
    - S = 104.70 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit;
  - Koeficienti i shfrytëzimit të sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore (ISPN) sipas PRrU- së është max 450 m<sup>2</sup>;
    - ISPN = max 450 m<sup>2</sup> / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”;
    - **Shtëpi familjare – Shtëpia**

- Sip = 265.68 m<sup>2</sup> / E gjitha mbi tokë,
- **Shtëpi familjare – Shtëpia**
- Sip = 224.73 m<sup>2</sup> / E gjitha mbi tokë,
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë - (ISHN), për vendosjen e ndërtesës në bazë – gabarit të bodrumit, sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është max 0.6 (60 %).
- **Shtëpi familjare – Shtëpia**
- S = 340 m<sup>2</sup> x 0.6 (60%) = 204 m<sup>2</sup> / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
- S = 0.00 m<sup>2</sup> / nuk ka bodrum, sipas projekt propozimit;
- **Shtëpi familjare – Shtëpia**
- S = 279 m<sup>2</sup> x 0.6 (60%) = 167.40 m<sup>2</sup> / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
- S = 0.00 m<sup>2</sup> / nuk ka bodrum, sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese – (ISHGJ), sipas pikës 2, paragrafi II. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01-031-185481 dt. 14.08.2015, sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës, e përcaktuar në bazë të Indeksit të Sipërfaqes së Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%.
- **Shtëpi familjare – Shtëpia - P+1 nr. Parcelës, 873-15 – I-28-8**
- S = 340 m<sup>2</sup> x 0.4 (40%) = 136 m<sup>2</sup> / sipas Vendimit të Kryetarit.
- S = 340 m<sup>2</sup> x 0.3 (30%) = 102 m<sup>2</sup> / sipas Vendimit të Kryetarit.
- S = 156.81 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit;
- **Shtëpi familjare – Shtëpia - P+1 nr. Parcelës, 873-16 – I-28-7**
- S = 279 m<sup>2</sup> x 0.4 (40%) = 111.60 m<sup>2</sup> / sipas Vendimit të Kryetarit.
- S = 279 m<sup>2</sup> x 0.3 (30%) = 83.70 m<sup>2</sup> / sipas Vendimit të Kryetarit.
- S = 135.13 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e PRrU-së “ Prishtina e Re – Zona Perëndimore”, distanca me e vogel nga parcela fqinjë të banimi individual është 3.0m. Teraset, shkallet e jashtme, ballkonet, konzollat etj nuk mund të ndërtohet në distance me të vogel se 3.0m nga parcela fqinjë;
- Rrethojt kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoje të gjelberta. Baza e rrethojes nuk duhet të jetë me e naltë se 50 cm, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojes mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përkaj rrugës ka lartësi prej max 1.5m ndërsa në kufi me parcelën fqinjë mund të jetë max 2.0 m;
- Qasja në parcelat kadastrale planifikohet sipas rrugës së planifikuar të planit rregullues;
- Për shtëpi individuale banimi duhet të sigurohet 1 vendparking, për njësi banimi. vendiparkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 40 % për gjelbërim;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Planit Rregullativ “Prishtina e Re – Zona Perëndimore”, si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit;

**V. Para aplikimit për leje ndërtimore, aplikuesit duhet:**

Të sigurojnë *Kushtet teknike nga KOSST-i apo KEDS-i* (varësisht nga tensioni i largpërçuesve), për ndërtim e shtëpive të planifikuara të ndërtesa individuale banimore-shtëpi familjare, në trajtim, meqenëse mbi parcelat kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 ZK Çagllavicë, përkatësisht përgjatë kufirit jug-lindje të saj, kalojnë largpërçuesit e tensionit të lartë;

**VI. Kycja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë);

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**VII. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50 m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe paralogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

**VIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcelat kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 Zona Kadastrale Çagllavicë, në bazë të certifikatës së njësisive kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës - tokë bujqësore, me kulturë 'arë e klasës 4', kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore

dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit - "zgjdhjes urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelave ndërtimore, me nr. 873-15, sip = 340 m<sup>2</sup> dhe nr. 873-16 sip = 279 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe të përgjithshme  $S = 340 \text{ m}^2 + 279 \text{ m}^2 = 619 \text{ m}^2$ .

Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, kjo Drejtori jep PËLQIM për ndërrimin e destinimit të tokës, vetëm për parcelën ndërtimore që do të ndërtohet.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**IX. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

**X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës**, do të realizohet sipas "Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

**XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore** do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## A r s y e t i m

Aplikuesit, Hilmi Bujupi nga fshati Arllat, Komuna e Glllogoc, me kërkesën 05 nr.350/02-239395/20 dt. 30.12.2020, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektit ideor, për ndërtimin e dy (2) shtëpive individuale të banimit/shtëpisë familjare me etazhitet P+1, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05 Nr. 350/02-239395/20 dt. 30.12.2020 dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni dhe provat, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë, kopjen e planit për parcelave kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914075-00873-15 dhe P-71914075-00873-16 ZK Çagllavicë në emër të pranarit Hilmi Bujupi, të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e

Komunës së Prishtinës (kopje të vërtetuara nga origjinali, i noterizuar te notere Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 6561/2020 dt. 27.10.2020);

- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Hilmi (Zeqe) Bujupi nr. Nr.239388/20 dt. 30.12.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Kopjen të dokumentit të identifikimit të Hilmi Bujupi;
- Shkresën “Informimin nga Plani Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” me referencë 04-350/01-228730/20 dt. 15.12.2020. të datës 24.12.2020, të lëshuar përmes sistemit online nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës;
- Inçizimin gjeodezik për parcelat kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 ZK Çagllavicë, i punuar nga kompania gjeodeze e licencuar “Geometika-Arch” me nr. të licensës 01;
- Aktin noterial “Autorizim për përfaqësim” i pronarit Hilmi Bujupi nga fshati Arllat, Komuna e Glllogoc, dhenë Arkitektve Ertan Sylejmani dhe Meriton Bajrami nga Prishtina, për përfaqësim pranë të gjitha organeve shtetërore të Republikës së Kosovës, i përpiluar dhe noterizuar te notere Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 6556/2020 dt. 27.10.2020; (kopje);
- Aktin noterial “Pëlqim” i pronari z.Hilmi Bujupi nga fshati Arllat, Komuna e Glllogoc, deklaroi se jep pëlqimin dhe pajtohem që parcela me P-71914075-00873-15 ZK Çagllavicë e cila evidentohet ne emrin tim, të ndërtojë objektin individual, sipas kushteve dhe lejes ndërtimore, në distancë prej 1m (një meter) nga kufiri i parcelës P-71914075-00873-11 ZK Çagllavicë pra pronar i të dyjave parcela, i përpiluar dhe noterizuar te notere Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 7527/2020 dt. 10.12.2020;
- Aktin noterial “Pëlqim”, i pronarve Suad dhe Miradije Imeri nga Prishtina, i cila jep pëlqim fqit të ynë z.Hilmi Bujupi nga nga fshati Arllat, Komuna e Glllogoc, të ndërtojë objektin individual, sipas kushteve dhe lejes ndërtimore, në distancë prej 1m (një meter) nga kufizi i parcelës P-71914075-00873-12 ZK Çagllavicë, i përpiluar dhe noterizuar te notere Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 6555/2020 dt. 27.10.2020;
- Një kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor të dy shtëpive individuale të banimit-shtëpisë familjare në kopje të fizike dhe kopje digjitale në CD, të hartuar nga kompania projektuese “Archipoints Group” Sh.p.k nga Prishtina, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810007709;

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-239395/20 dt. 30.12.2020, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni - Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, ka konstatuar se parcelat kadastrale nr. 873-15 dhe 873-16 ZK Çagllavicë, shtrihen në kuadër të parcelave ndërtimore “I-28-7” dhe “I-28-8”, të bllokut urban “I-28”, të tërësisë urbane “I”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-186850 dt. 02.10.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Sipërfaqet e destinimit rezidencial për banimi individual”.

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 23.02.2021 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m`, për të njoftuar publikun me synimin e pronarëve dhe investitorit, për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t`ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 27.02.2021, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të saj, bazuar në analizën urb-arkitektonike - të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, dhe projektit konceptual - “zgjidhja urbane”, është konstatuar se ndërtesat e planifikuara të pozicionohet në distancë 1.00 m`, nga kufiri i parcelës kadastrale fqinje nr.

783-11 ZK Çagllavicë, dhe në distancë 1.0 m', nga kufiri i parcelës kadastrale nr. 783-12 ZK Çagllavicë, pas sigurimit dhe prezantimit të aktit noterial "Pëlqim" të Hilmi Bujupi nga fshati Arllat Komuna e Gllogoc, pronar i parcelës kadastrale nr. 783-11 ZK Çagllavicë, dhënë vetës edhe si pronarë i këtyre parceleve z.Hilmi Bujupi nga fshati Arllat Komuna e Gllogoc, për lejimin e ndërtimit të shtëpisë deri në 1 (një) metër afër kufirit të parcelës, e noterizuar te noterja Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 7527/2020 dt. 10.12.2020, dhe aktit noterial "Pëlqim", të pronarve Suad dhe Miradije Imeri nga Prishtina, pronarë të parcelës kadastrale nr. 783-12 ZK Çagllavicë, dhënë Hilmi Bujupi nga fshati Arllat Komuna e Gllogoc, për lejimin e ndërtimit të shtëpisë në kufirin e parcelës së tij deri në 1 (një) metër, e noterizuar te notere Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 6555/2020 dt. 27.10.2020;

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kycje të parcelës në rrugën ekzistuese të lagjes, dhe është konstatuar, si në vijim:

*"Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Hilmi Bujupi, ne lagjen Prishtina e re, Zona Perëndim ZK. Çagllavicë, Prishtinë, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-239395/20 dt.30.12.2020, kyçjet për automjete në rrugën e planifikuar, sipas prezantimit në situacion për dy ndërtesat banimore - shtëpi individuale me etazhitet P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë. Kyçjet duhet ti përshtaten teknikisht rrugës dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve edhe në kohën kur realizohet ajo".*

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjitha dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit – "zgjidhja urbane", është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i Situacionit – zgjidhja urbane dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ Kosovaref01" të punuar nga kjo Drejtori.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

**Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesit, në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-239395/20 dt. 30.12.2020, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**05 NR. 350/02-239395/20 Dt. 24.03.2021**

Zyrtari,  
Ardian Zymeri

u.d Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha - Prestreshi



Drejtor i Drejtorisë,  
Ardian Zymeri








Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE  
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN  
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:  
Kushtrim Domaneku

Prishtinë: 12.03.2021

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat kadastrale



